



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO ZA TRGOVINU I INDUSTRIJU
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

PROFILI I SEKTORIT TË INDUSTRIË SË PËRPUNIMIT TË METALIT







SEKTORI I PËRPUNIMIT TË METALIT NË KOSOVË

Mars 2014

Mirënjohjet dhe Falenderimet

Ky raport është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës brenda kornizës së angazhimeve përmes projektit “Ndihmë Tregtisë”, implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND

Për realizimin e këtij raporti kontribut i veçant është dhënë nga:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë:

Kabineti i Ministrit
Departamenti i Industrisë
Departamenti i Integriteteve Evropiane dhe Koordinimit të Politikave
Agjencia për Mbështetje të Investimeve dhe Ndërmarrjeve në Kosovë

Anketimi në terren realizuar nga TNS Index Kosova,
Agjenci për hulumtime sociale, të mediave dhe marketingut

Kontrolli i Cilësisë:

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Kosovë
Njësia për Politika, Hulumtime, Çështje gjinore dhe komunikim
Njësia për Zhvillim Gjithpërfshirës
Projekti “Ndihmë Tregtisë”
Petrit Gashi, Phd – Konsulent i Jashtëm

Autor

Agon Maliqi

Përkthyes në gjuhën Shqipe:

Hyjnor Jasiqi

Dizajni: “XHAD Studio”, Prishtinë

Shtypi: “Grafika Rezniki” Prishtinë

Si dhe një falenderim i veçantë për të gjithë respondentët e përfshirë në hulumtim.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të pjesëmarrësve dhe të autorëve, dhe në asnjë mënyrë nuk përfaqësojnë qëndrimet zyrtare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Finlandës.

E drejta autoriale © 2014. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja

Mirënjohjet dhe Falenderimet	2
Lista e shkurtesave	4
1. Hyrje	5
2. Informata bazike për kompanitë	8
Rubrika 1: Profili i një biznesi të suksesshëm që vepron në Kosovë	12
3. Kontributi dhe prodhimi në kompani dhe industri	13
4. Tregjet.....	18
Rubrika 2: Rregulloret tregtare	23
5. Punësimi dhe kapacitetet njerëzore.....	24
Rubrika 3: Legjislacioni i tregut të punës në Kosovë: përmbledhje.....	28
6. Asetet dhe investimet.....	29
7. Mjedi i biznesit	33
Rubrika 4: Tatimet e sektorit.....	35
Rubrika 5: Lista e institucioneve kryesore relevante për sektorin	35
Rubrika 6: Licencat dhe lejet që kanë të bëjnë me sektorin	36
Rubrika 7: Ligjet që lidhen drejtpërsëdrejti me sektorin	36
8. Konkluzë	39

Lista e shkurtesave

NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
NACE	Nomenclature des Activités Économiques dans la Communauté Européenne/ Kategorizimi statistikor i veprimtarive ekonomike në Komunitetin Evropian
SH.P.K.	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
SH.A.	Shoqëri aksionare

1. Hyrje

Qëllimi i këtij profili të sektorit është që të sigurohet një pasqyrë e karakteristike kryesore të sektorit të përpunimit të metalit në Kosovë. Duke shfrytëzuar burime zyrtare të të dhënave (aty ku ato ishin në dispozicion) si dhe të dhëna nga anketa specifike për sektorin, ky profil sektori ofron informata për: a) karakteristikat bazike të kompanive që veprojnë në sektor; b) strukturën e kontributeve dhe prodhimeve; c) qarkullimin e kompanive dhe sektorit, tregjet dhe llojet e blerësve; d) asetet e kompanive dhe sektorit, teknologjinë dhe investimet; e) kapacitetet e burimeve njerëzore, dhe; f) perceptimet e kompanive për mjedisin e biznesit. Informatat për këto tema janë paraqitur në kapituj të veçantë.

Anketa për këtë profil të sektorit është kryer me një mostër përfaqësuese prej 144 kompanive aktive në përpunimin e metalit. Mostra është përzgjedhur duke shfrytëzuar të dhënat për karakteristikat e kompanie (si lloji i veprimtarisë ekonomike dhe numri i punonjësve) të nxjerra nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)*1. Duke ngushtuar sektorin e përpunimit të metalit që përbëhet nga 216 kompani aktive, rezultatet nga kjo mostër prej 144 kompanive – duke aplikuar përzgjedhje të rastësishme të mostrës për kompanitë mikro dhe përzgjedhje të synuar të kompanive më të mëdha – kanë nivel të besueshmërisë prej 95% dhe 5% interval të besueshmërisë. Për shkak të faktit që për disa nga pyetjet shkalla e përgjigjes ishte e ulët (posaçërisht për disa pyetje që kompanitë i vlerësonin si më të ndjeshme), ky profil sektori nuk i paraqet të gjitha informatat që mund të jenë relevante dhe të rëndësishme për sektorin, por vetëm ato që konsiderohen të jenë më të besueshme.

Të dhënat zyrtare dhe gjetjet e anketës sugjerojnë që sektori i përpunimit të metalit karakterizohet nga një grup i vogël i kompanive të mëdha (industri tradicionale të zhvilluara kur Kosova ishte pjesë e ish Jugosllavisë, shumica e të cilave tashmë janë privatizuar) të cilat përbëjnë përpjesën më të madhe të prodhimit, eksporteve dhe punësimit (3/4 të kësaj të fundit). Këto janë ose kompani të cilat shfrytëzojnë resurset e pasura të Kosovës me xehe të metaleve (p.sh. nikelit) për të prodhuar metale bazë që zakonisht eksportohen, apo prodhimin e produkteve fundore (tuba të çeliktë, gypa të çeliktë, radiatorë për ngrohje, produkte të galvanizuar të çelikut, etj.) Kosova gjithashtu ka një segment të gjallë të kompanive mikro dhe të vogla të cilat janë zhvilluar si pasojë e bumit të ndërtimit pas vitit 1999 dhe të cilat, siç edhe sugjeron anketa, po hasin në vështirësi në avancimin dhe zgjerimin e tyre si pasojë e disa pengesave (kryesisht të brendshme).

1 * Shënim metodologjik: Sektori i përpunimit të metalit është përkufizuar si sektor që përbëhet nga kompanitë (me përjashtime) që kanë të listuara dy veprimtaritë në vijim (duke përdorur kategorizimin evropian dyshifror të veprimtarive të industrisë – kodet NACE Rev.1) si veprimtaria e tyre kryesore: 27 – Prodhimi i metaleve bazë dhe; 28 – Prodhimi i produkteve të fabrikua të metalit. Mostra gjithashtu përfshin kompanitë që kanë të listuara veprimtaritë 1310 (Nxjerrja e mineralit të hekurtit) dhe 1320 (Nxjerrja e mineralit të metaleve joferromanjetike) si veprimtarinë e tyre kryesore dhe kishte prodhimin si sekondare. Përveç kësaj, për shkak të: a) numrit të madh të kompanive; b) mbipopullimit nga punëtorë të vetëpunësuar të angazhuar në veprimtari të vogla të riparimit apo përpunimit jometalik (p.sh. automekanikë); c) vlerës së ulët të veprimtarive brenda sektorit total – të gjitha kompanive mikro (<9 punëtorë) që listojnë veprimtaritë vijuese si kryesore janë larguar: 2811 (Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre); 2812 (Prodhimi i armaturave, dritareve, portave metalike e të ngjashme) dhe 2852 (Punime të përgjithshme mekanike). Kjo ka çuar në mostër prej 216 kompanish.

Kompanitë e përpunimit të metalit janë pothuajse tërësisht në pronësi private dhe janë të shpërndara anekënd Kosovës, numri më i madh i të cilave janë në rajonin e Prishtinës. Këto kompani punësojnë rreth 1.5% të gjithsej popullatës së punësuar në Kosovë. Kompanitë e këtij sektori kryesisht janë në pronësi të burrave, meqë vetëm 5% të fuqisë punëtore janë gra dhe vetëm 7% të kompanive janë aksionarë gra. Më 2012, mallrat e eksportuara nga sektori (metalet bazë dhe produktet e metaleve, përjashtuara metalin skrap) përbënin 36.5% të gjithsej vlerës së eksporteve të Kosovës.

Mesatarisht, kompanitë e përpunimit të metalit kanë raportuar se kanë operuar me 63% të kapacitetit të tyre më 2012. Gama e mallrave që janë prodhuar nga sektori është e gjerë. Numri më i madh i kompanive të regjistruara – kryesisht kompani mikro dhe të vogla – janë përgjithësisht të përfshirë me prodhimin e konstrukteve dhe produkteve të metalit që përdoren në industrinë e ndërtimit. Veprimtaria tjetër kryesore më e shpeshtë është prodhimi i komponentëve të metalit përmes veprimtarisë së përpunimit metalurgjia pluhur dhe trajtimi dhe veshja e metaleve, si dhe prodhimi i produkteve të metaleve të çmuara, fijeve dhe aluminit. Megjithatë, në kuptim të vlerës së tregut të prodhimeve, veprimtaria bindshëm më e rëndësishme është ajo e përpunimit të ferronikelit, vijuar nga hekuri për përdorim fundor dhe produktet e çelikut.

Bazuar në një përzierje të të dhënave të anketës dhe burimeve dytësore, qarkullimi i sektorit të përpunimit të metalit në Kosovë më 2012 vlerësohet të ketë qenë $\approx$ €114 milionë. Megjithatë, duke marrë parasysh faktin që viti 2012 ishte viti jashtëzakonisht i keq për eksportet e ferronikelit dhe se përgjigjet në anketë për sa i përket qarkullimit nuk janë të besueshme si pasojë e një shkallë të konsiderueshme të mosdeklarimit, ka arsye të forta për të besuar se në një vit të mirë për eksportet e nikelit, vlera e qarkullimit të sektorit do të ishte më afër shifrës €200 milionë.

Shtatëmbëdhjetë për qind e të gjitha kompanive të përpunimit të metalit aktualisht janë të angazhuara në një shkallë të eksportit. Megjithatë, vetëm kompanitë e mesme dhe të mëdha janë të orientuara kryesisht në eksporte dhe i shesin shumicën e mallrave jashtë vendit. Struktura e eksporteve të metalit dominohet në masë të madhe nga ferronikeli, që përbënte 90.8% të gjithsej vlerës së metaleve të eksportuara në periudhën 2010-2012. Pjesa më e madhe e mbetur e eksporteve (6.6%) përbëhet nga produktet e hekurit dhe çelikut – kryesisht gypa, tuba dhe profile boshe. Kompanitë mikro dhe të vogla të përpunimit të metalit i shesin gati të gjitha mallrat e tyre në tregun vendor – rreth 90% e vlerës së tyre të prodhimit shitet brenda vendit.

Anketa ka gjetur se shumë kompani të përpunimit të metalit – posaçërisht kompani të vogla – po kërkojnë mënyra për të zgjeruar veprimtarinë e tyre dhe për t'u bërë eksportues. Shumica e tyre mendojnë se pengesat më të mëdha janë faktorët brenda kompanisë dhe shumë prej tyre po ndërmarrin hapa për ta rritur konkurrueshmërinë e tyre. Për këtë qëllim, 19.7% të të gjitha kompanive, dhe 28.6% të kompanive të vogla, kanë raportuar të kenë bërë investime kapitale më 2012. Pothuajse të gjithë prej tyre kanë thënë se kanë investuar në avancimin e teknologjisë së tyre të procesit të prodhimit duke blerë makineri apo mjete. Vlera mesatare e investimeve të kompanive të vogla më 2012 ishte €72,500. Si rrjedhojë, vlera totale e teknologjisë së popullatës së përzgjedhur të sektorit të NVM-ve ka përjetuar rritje vjetore prej 10%.

Megjithatë, përkundër përpjekjeve të kompanive për të zgjeruar dhe rritur konkurrueshmërinë e tyre, anketa ka konstatuar se para tyre janë sfida të shumta. Investimet e mëtejme në teknologji po pengohen nga kostoja e lartë e financimit, të cilën kompanitë e përpunimit të metalit e konsiderojnë si shumë të lartë (24.6%) apo të lartë (21.4%). Që nga tetori 2013, norma e kamatës në kreditë investuese deri në pesë vite ishte 10.2%. Megjithatë, një shkallë e fleksibilitetit dhe nxitjes për investime

është duke u zhvilluar nga një varg skemash stimuluese të qeverisë – si largimi i detyrimeve doganore dhe zbritjet tatimore për investime kapitale.

Përveç teknologjisë, një sfidë tjetër e rëndësishme është fuqia punëtore dhe kualifikimet e saj. 46% të kompanive të vogla të sektorit mendojnë se ka mungesë të punonjësve të kualifikuar në tregun e punës. Llojet e profesionistëve të kualifikuar që përmenden më së shpeshti të vështirë për t'u gjetur në tregun e punës janë mbikëqyrësit e fabrikës – gjegjësisht operatorë të furrave, ekspertë të shkrirjes, operatorët të trajtimit të ngrohjes dhe bartës – përcjellë nga punonjës të fleta metalike, operatorë të makinerive, makina për bluarjen e metalit, etj. 20.1% të të gjitha kompanive të sektorit (duke përfshirë shumicën e kompanive të mëdha) kanë raportuar se ofrojnë trajnime në vend të punës për punonjës të tyre.

Kur janë kërkuar që t'i vlerësojnë pengesat e mjedisit të tyre të biznesit në shkallë, kompanitë e përpunimit të metalit gjithashtu kanë theksuar ndikimet e rënda të korrupsionit dhe konkurrencës nga ekonomia joformale. Por, pengesa që ka marrë rezultatin më të lartë mesatar në shkallë ishte fuqia e ulët blerëse në tregun e brendshëm. Duke pasur parasysh se importet e metaleve janë në rritje të vazhdueshme përgjatë viteve dhe se rritja ekonomike ka qenë pozitive, ky shqetësim i shprehur nga kompanitë mund të jetë shenjë se tregu i brendshëm është ngopur për strukturën e tanishme të prodhimit, ku shumë kompani shesin të njëjtat mallra dhe shërbime, dhe se rritja e kompanive nuk është e mundur pa diversifikimin e produkteve/shërbimeve të përshtatura për tregun e brendshëm dhe/ose zgjerimi në tregjet e huaja. Kjo e bën nevojën aktuale për inovacion më të fortë, zgjerim të konkurrueshmërisë dhe orientimit drejt eksporteve urgjencë edhe më të madhe.

2. Informata bazike për kompanitë

Që nga nëntori 2013, në Kosovë vlerësohej se vepronin 216 kompani të përpunimit të metalit. Ky numër është marrë bazuar në të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe në bazë të veprimtarisë ekonomike që kompanitë e kanë listuar si primaren (shih shënimin metodologjik në pjesën e Hyrjes së këtij raporti për më shumë informata për metodologjinë). Baza e të dhënave e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) ka shumë më shumë kompani të listuara si të angazhuara në veprimtari të përpunimit të metalit, por përgjithësisht supozohet se për shkak të numrit të madh të kompanive joaktive, baza e të dhënave e ATK-së është më afër reflektimit të nivelit të vërtetë të veprimtarisë.


Siç edhe ilustron Tabela 1, shumica dërmuese (81.9%) e kompanive të sektorit janë kompani mikro (177 kompani gjithsej) me më pak se 9 punonjës. Pastaj janë kompanitë e vogla që kanë ndërmjet 9 dhe 50 punonjës. Në anën tjetër, janë pesë kompani të mesme dhe të mëdha – gjigantë të vjetër të industrisë të themeluar gjatë kohës së komunizmit – që dominojnë mbi këtë sektor në kuptim të numrit total të punonjësve dhe, me disa përjashtime të theksuara, prodhimit dhe qarkullimit. Vetëm 7% të kompanive kanë gra të listuara si pronare.

Tabela 1: Numri i vlerësuar i kompanive aktive të përpunimit të metalit në vitin 2012, sipas madhësisë së kompanive

Madhësia e kompanisë (numri i punëtorëve)	Nr. i kompanive në bazën e të dhënave të ATK-së	% e kompanive
Mikro (<9)	177	81.9%
Të vogla (9-50)	34	15.7%
Të mesme (50-250)	2	0.9%
Të mëdha (250 +)	3	1.4%
GJITHSEJ	216	100%

Burimi: ATK, 2013

Për sa i përket përqendrimit rajonal të kompanive të përpunimit të metalit, rajoni i Prishtinës ka numrin më të madh (gjithsej 78) të tyre, duke përfshirë kompaninë më të madhe në kuptim të vlerës së prodhimit dhe qarkullimit (Ferronikeli, me vendndodhje në Gllogoc). Siç është ilustruar në Figurën 1, rajoni i Prishtinës gjithashtu ka numrin më të madh të kompanive të vogla (12). Rajonet jugore të Gjakovës dhe Prizrenit, në anën tjetër, kanë përqendrimin e dytë më të madh të kompanive të këtij sektori, me 38 dhe 33 përkatësisht. Megjithatë, këto dy rajone kanë vetëm kompani mikro dhe të vogla dhe, ndryshe nga Ferizaj, Gjilani, Mitrovica dhe Prishtina – nuk kanë gjigantë industrialë.

Figura 1: Numri total i kompanive të sektorit, sipas rajonit dhe madhësisë

Burimi: ATK, 2013

Kompanitë e sektorit mund të grupohen në disa kategori kryesore të përpunimit, bazuar në kategorizimin e veprimtarive të NACE Rev. 1. Siç është ilustruar në Figurën 2, numri më i madh i kompanive (33) listohet në një kategori të papërkufizuar – gjegjësisht, prodhimi i “produkteve të tjera të metaleve” – si linjën kryesore të veprimtarisë së tyre. Këto kompani me gjasë janë të përfshira në prodhimin e konstrukteve të metalit që përdoren nga industria e ndërtimit. Grupi i dytë më i madh i kompanive (32) janë kryesisht të përfshira në metalurgjinë e pluhurit – gjegjësisht në farkëtimin, shtypjen, thyerjen dhe formimin e metaleve (d.m.th. ngrohjen e metaleve pluhur afër pikës së tyre të shkrirjes) për të prodhuar pjesë dhe komponentë të ndryshëm metalikë që pastaj përdoren nga industritë e tjera, siç është ajo e automobilave, apo në prodhimin e pajisjeve, mjeteve e veglave shtëpiake, etj.


Grupi i tretë më i madh (26) përfshin veshjen dhe trajtimin e metaleve, ndërsa grupet tjera më të mëdha kanë të bëjnë me prodhimin e metaleve të çmuara (17), produkteve të fijeve (16) dhe aluminit (16). Siç është ilustruar në diagram (Figura 2), kompanitë mikro përbëjnë pjesën më madhe të këtyre grupeve. Kështu, këto grupe në majë të listës nuk paraqesin peshën e vërtetë të veprimtarive të sektorit në kuptim të vlerës së prodhimit dhe qarkullimit. Siç është ilustruar në Tabelën 2 në vijim, veprimtaria kryesore e përpunimit për pesë kompanitë më të mëdha ndryshon nga lista e veprimtarive të para në sektorin e NVM-ve.

Tabela 2: Veprimtaritë kryesore dhe dytësore të pesë kompanive më të mëdha

Newco Ferronikeli	1320: Nxjerrja e mineralit të metaleve joferromanjetike; Sekondare: Përpunimi i xeheve të nikelit.
Trepça	1320: Nxjerrja e mineralit të metaleve joferromanjetike; Sekondare: Përpunimi i zinkut, kallajit dhe xeheve të plumbit.
NewCo Llamkos – Galvasteel	2710: Prodhimi i metalit të hekurit, çelikut dhe prodhimi i legurave të jashtme; Sekondare: Produktet e rrafshëta dhe të përfunduara të çelikut.
Fabrika e tubave NewCoIMK	2811: Prodhimi i konstrukcioneve metalike dhe pjesëve të tyre;
NewCo Jugoterm	2822: Prodhimi i radiatorëve dhe kazanëve me avull për ngrohje qendrore;

Burimi: ARBK, 2013

Figura 2: Veprimtaria më e shpeshtë e kompanive në sektor (kodet e NACE Rev.1)



2875:Produkte të tjera të metalit; 2840: Metalurgjia e pluhurit; 2851: Përpunimi dhe pasurimi i metaleve; 2741:Prodhimi i metaleve të çmuara; 2873: Produktet e fijeve metalike; 2742: Alumin.

Burimi: ATK, 2013


Tabela 3 ilustron që shumica dërmuese e kompanive të sektorit (89.6%) janë të regjistruara si biznese individuale, ndërsa grupi i dytë i kompanive për nga madhësia (6.3%) kanë status juridik të Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar (6.3%). Kjo strukturë e pronësisë është pasqyrim i faktit që shumica e kompanive të sektorit janë kompani mikro (81.9%). Marrëdhënia ndërmjet madhësisë së kompanive dhe pronësisë është konfirmuar me faktin që tek kompanitë e vogla përpjesa e bizneseve individuale është më e ulët se (75%), ndërsa përqindja e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara më e lartë (17.8%) sesa në popullatën e plotë të kompanive. Vetëm dy nga kompanitë e anketuara janë ndërmarrje publike, ndërsa dy të tjera të regjistruara si kompani të huaja. Figura 3 tregon se përqindja më e madhe e kompanive janë në pronësi të ndërmarrësve të moshës ndërmjet 45-55 vjeç (31.2% të kompanive) dhe 35-45 vjeç (29.9%).

Tabela 3: Kompanitë e sektorit sipas llojit të statusit juridik

Lloji i kompanisë	% të të gjitha kompanive në sektor	% të kompanive të vogla
Biznes individual	89.6 %	75 %
Ortakëri e përgjithshme	0.7 %	3.5 %
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (SH.P.K.)	6.3 %	17.85%
Shoqëria aksionare (SH.A.)	0.7 %	-
Kompani e huaj	1.4%	3.5 %
Ndërmarrje publike	1.4%	-

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Figura 3: Shpërndarja e pronësisë në kompani sipas grupmoshës



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Rubrika 1: Profili i një biznesi të suksesshëm që vepron në Kosovë

Me seli në qytetin e Ferizajit, Elsam është prodhues i një game të gjerë të konstruksioneve metalike, këmbyesve të nxehtësisë dhe rezervuarëve – një nga furnitorët kryesorë të këtyre produkteve në tregun vendor. Ndonëse ka kompani të tjera më të mëdha, më të suksesshme të përpunimit të metalit që tanimë i eksportojnë mallrat e tyre dhe që mund të konsiderohen si histori më të mira suksesi, historia e kompanisë Elsam është e rëndësishme sepse është përfaqësuese e një grupi relativisht të konsiderueshëm dhe me përvojë të prodhuesve të metalit që ka mundësi t'i bashkohet grupit të eksportuesve në të ardhmen. I themeluar më 1984 si ndërmarrje shoqërore dhe e privatizuar më 2006, Elsam aktualisht ka statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe është në pronësi të ndërmarrësve vendorë. Ndërmarrja ka të punësuar rreth 45 punëtorë ka punëtori të madhësisë së konsiderueshme.

Produktet dhe/ose shërbimet e Elsam i përshtaten një game të gjerë të blerësve dhe llojeve të projekteve të ndërtimit: nga projektet e infrastrukturës publike deri te objektet private të banimit apo industriale. Elsam prodhon produkte të punuara enkas të përdorimit fundor, si konstruksione të çelikut për ndërtim (shufra, trarë dhe shtylla) ose këmbyesit të nxehtësisë që më së shpeshti përdoren në termocentrale, ndërtesa të banimit ose industrisë kimike. Fushat tjera të ekspertizës përfshijnë ndërtimin e një game të larmishme të rezervuarëve, që përdoren nga objektet e banimit ose ato industriale për t'i ruajtur lëndët djegëse ose lëngjet tjera.

Elsam aktualisht i shet të gjitha mallrat në tregun vendor, ku investimet në infrastrukturën publike dhe projektet e patundshmërisë e mbajnë mjaft të lartë kërkesën për produktet e saj. Por sikurse edhe disa kompani të tjera të kësaj madhësie, bazuar në fuqinë e punëtorëve të kualifikuar (inxhinierë me shkollim të lartë) dhe përvojën e gjerë në menaxhimin e projekteve, Elsam ka potencial, interesin dhe me siguri edhe nevojë të ardhshme komerciale, që t'i diversifikojë shitjet dhe të zgjerohet në tregjet e eksportit. Ky potencial për zgjerim, megjithatë, do të varet nga disa faktorë të cilësisë dhe koston të cilat sipas anketës janë më problematike për bizneset e vogla si Elsam që kërkojnë të ngriten. Një sfidë e posaçme është kostoja e lartë e investimit në makineri të reja dhe numri i kufizuar i punonjësve në dispozicion për të operuar me impiantet e sofistikuara. Natyra e shitjeve ndërmjet bizneseve gjithashtu thekson rolin e rëndësishëm të rrjetëzimit në sigurimin e informatave të tregut të eksportit dhe arritjes së qasjes tek klientët potencialë.

3. Kontributi dhe prodhimi në kompani dhe industri

Anketa që është kryer për qëllime të këtij profili të sektorit i ka pyetur kompanitë lidhur me strukturën e prodhimeve të tyre – gjegjësisht shumën e parave që i shpenzojnë në muaj në lëndë të parë, produkte të ndërmjetme, paga, derivate, rrymë, ujë, etj. Pastaj janë kalkuluar vlerat monetare mujore për ta nxjerrë koston mesatare vjetore sipas llojit të kontributit, shpenzimin mesatar dhe total vjetor për të gjitha kontributet, si dhe vlerën që secili kontribut ofron për sektorin në tërësi. Përqindjet përkatëse janë paraqitur në Tabelën 4.

Duhet të theksohet se shkalla e përgjigjes nga kompanitë për kostot e kontributeve ishte e kënaqshme, me përjashtim të tri kompanive të mëdha të cilat nuk ishin të gatshme të ofrojnë asnjë informatë për shpenzimet e tyre për kontribute. Kjo është arsyeja pse të dhënat për kontributet janë të kufizuara vetëm në pjesën e NVM-ve në sektor. Gjithsej, 69% të NVM-ve të anketuara (98 nga 141) u janë përgjigjur pyetjeve për kostot mujore të lëndës së parë dhe produkteve të ndërmjetme. Shkalla e përgjigjes për shpenzimet tjera për kontribute ishte shumë më e lartë – energji elektrike (97%), fuqi punëtore (90%), derivate (90%) dhe ujë (87%).

Siç është ilustruar në Tabelën 4, lënda e parë dhe mallrat e ndërmjetme përbëjnë pjesën më të madhe të kostos së kontributeve për kompanitë e sektorit – gjegjësisht, 76.9% të vlerës totale të sektorit për kontribute. Kostoja e dytë më e madhe e kontributit është fuqia punëtore (13.8%), vijuar me derivatet (3.4%) dhe energjinë elektrike (1.9%). Kostoja e ujit është tejet marginale (0.1%). Megjithatë, sikurse që tregon tabela, pjesa e disa kontributeve të caktuara në vlerën totale ndryshon varësisht nga madhësia e kompanisë. Kompanitë e mesme, për shembull, shpenzojnë një përqindje më të ulët në lëndë të parë dhe përpjesë më të lartë në paga sesa kompanitë mikro dhe të vogla. Përqindja e kostove të energjisë elektrike në kuadër të strukturës së kontributeve rritjet sipas madhësisë së kompanisë së kompanive, duke pasqyruar nivelet më të larta të mekanizmave dhe me këtë të kërkesës për energji elektrike.

Pas nxjerrjes së shumave mesatare për 213 NVM-të që veprojnë në këtë sektor, vlerësimi është se këto kompani kanë shpenzuar rreth €57.8 milionë në kontribute më 2012, përqindja më e madhe e së cilave – €44,5 milionë – është shpenzuar në lëndë të parë dhe produkte të ndërmjetme.

Tabela 4: Përpjesa e kostove të kontributeve në NVM në kuadër të kontributeve totale sipas sipas madhësisë së kompanisë


				Përqindja e kostove të kontributit në kuadër të gjithsej kontributeve sipas madhësisë së kompanisë		
Lloji i kontributit	Shpenzimi mesatar vjetor	Shpenzimet e përafërta totale sipas NVM në sektor (213 kompani) (€)	Përpjesa e kostos së kontributeve në kuadër të gjithsej kontributeve (%)	Mikro	Të vogla	Të mesme
Lëndë e parë dhe materiale	208,902	44,496,230	76.9	75.4	78.2	67.2
Punëtorë	37,499	7,987,300	13.8	14.5	11.1	25.5
Të tjera	10,545	2,245,981	3.9	5.4	4.9	0.2
Derivate	9,251	1,970,516	3.4	3.6	4.1	1.3
Energji elektrike	5,082	1,082,382	1.9	0.9	1.5	5.8
Ujë	293	62,498	0.1	0.1	0.1	0.1
Të gjitha kontributet	271,572	57,844,909	100	100	100	100

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Një tjetër vlerë e shtuar e anketës është se ajo ka paraqitur një mundësi të rrallë për t'i parë burimet e lëndës së parë dhe materialeve, duke i identifikuar akterët kryesorë në zinxhirin e furnizimit në industri. Për këtë qëllim, kompanitë janë kërkuar që ta ndajnë vlerën totale të lëndës së parë dhe materialeve që i kanë përdorur sipas llojit të furnitorit që i ka siguruar ato. Më saktësisht, ata e kishin opsionin që të deklarojnë se sa për qind e lëndës së tyre të parë dhe të materialeve ishin mallra vendore (të prodhuara “vetë” apo nga “prodhues të tjerë vendorë”) dhe sa për qind ishin mallra të huaja (të furnizuara nga “tregtarë vendorë”, “tregtarë të huaj” apo “drejtpërsëdrejti nga prodhues të huaj”).

Siç është ilustruar në Figurën 4, një përqindje e konsiderueshme e vlerës totale të lëndës së parë dhe materialeve të ndërmjetme (36.8%) prodhohen në tregun vendor, qoftë nga kapacitetet vetjake (17.1%) qoftë nga prodhuesit tjerë vendorë (19.7%). Megjithatë, shumica e lëndës së parë dhe materialeve të ndërmjetme janë të importuara, ku tregtarët vendorë luajnë një rol të rëndësishëm në zinxhirin e vlerës (33.3%). 20.3% të tjera të vlerës totale të lëndës së parë furnizohen drejtpërsëdrejti nga prodhues të huaj, ndërsa vetëm 9.5% blihen nga tregtarë të huaj.

Figura 4: Përqindja e vlerës totale të lëndës së parë dhe materialeve të ndërmjetme që përdoren nga NVM-të në sektor (në %), sipas llojit të furnitorit



Burimi: Anketa e UNDP, 2013


Gjithsej vlera e prodhimit nga industria e përpunimit të metalit në Kosovë është e vështirë për t'u konstatuar për shkak të nëndeklarimit nga kompanitë e anketuara të sektorit. Një numër i konsiderueshëm i NVM-ve nuk është përgjigjur në pyetjet që kishin të bënin me vlerën e prodhimit të tyre (91 nga 141), por mesatare rezultuese të prodhimit dhe totale të nxjerra nga përgjigjet e tyre janë shumë më të ulëta – më pak se gjysma – sesa vlera e kontributeve të raportuara. Për më tepër, asnjë nga kompanitë e mëdha (të cilat përbëjnë përqindjen bindshëm më të madhe të prodhimit në industri) nuk kanë ofruar informata për prodhimet e tyre, duke vështirësuar nxjerrjen e vlerës totale të prodhimit për industrinë.

Megjithatë, edhe nëse prodhimi është i nëndeklaruar, nuk ka arsye të besohet se ka paragjykim të fuqishëm në natyrën e nëndeklarimit – gjegjësisht, kompanitë i kanë nëndeklaruar prodhimet e tyre pavarësisht nga madhësia apo lloji i veprimtarisë së përpunimit. Prandaj dhe të dhënat nga anketa për prodhimin e NVM-ve japin mundësi të përcaktohet së paku përqindja e prodhimit që përbëjnë veprimtaritë e ndryshme të përpunimit të metalit në sektor, pavarësisht vlerave të tyre të përgjithshme monetare. Siç është ilustruar në Figurën 5, përqindja më e madhe e vlerës së prodhimit (pavarësisht shumës totale) në pjesën e NVM-ve përbëhet nga kompanitë që kanë listuar prodhimin e tubave të çelikut (35%) si veprimtarinë kryesore të tyre të përpunimit. Përqindja e dytë për nga madhësia përbëhet nga prodhimi i strukturave dhe pjesëve metalike (12%), vijuar nga prodhimi i metaleve me ngjyrë (9%), "prodhimi i produkteve të tjera metalike" (9%) dhe përpunimi me shkrirje të hekurit dhe çelikut (8%).

Për sa i përket pesë kompanive më të mëdha dhe dominuese në industri, struktura e prodhimit është e ndryshme dhe, për shkak të përgjigjeve të pamjaftueshme në pyetjet e anketës, ajo duhet të nxirret duke kombinuar anketën dhe burime sekondare. Të dhënat për eksportet (do të diskutojmë më vonë) konfirmojnë se prodhimi i ferronikelit (në impiantin Ferronikeli në Glllogoc) përbën përqindjen më të madhe të prodhimit jo vetëm të kompanive të mëdha, por edhe në tërë industrinë e përpunimit të metalit.

Një nga prodhuesit tjerë më të mëdhenj në Kosovë, Llamkos – Galvasteel, prodhon një spektër të gjerë të produkteve të çelikut të galvanizuar – duke filluar me produkte të sheshta (fletë dhe mbështjellës të galvanizuara), deri tek produktet fundore si sistemet e ventilimit, kontejnerë të mbeturinave, ulluqe, fletë të profilizuara, etj. Për shkak disa kontesteve komplekse politike dhe juridike, si dhe dekadave të mungesës së investimeve dhe neglizhencës, kompleksi industrial Trepça, dikur kampion i industrisë së Kosovës, aktualisht është zvogëluar në mihjen e zinkut dhe xeheve të plumbit. Fabrika e Tubave NewCo IMK me seli në Ferizaj është e specializuar në prodhimin e tubave të çelikut për sisteme të ndryshme të furnizimit (ujë, gaz dhe naftë), ndërsa Jugoterm në Gjilan prodhon radiatorë për ngrohje.

Figure 5: Përpjesa e vlerës së prodhimit të NVM-ve sipas veprimtarisë kryesore të përpunimit.




2722 – Prodhimi i tubave prej çeliku; 21 – Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre; 2745 – Prodhimi i metaleve me ngjyrë (p.sh. alumini); 2875 – Prodhimi i produkteve të tjera metalike; 2731 – Tërheqja në të ftohtë.

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Anketa gjithashtu ka pyetur kompanitë e sektorit për nivelin e shfrytëzimit të kapacitetit të tyre të prodhimit gjatë dy viteve të fundit (2011 dhe 2012) dhe ka pranuar shkallë të përgjigjeve prej 95%. Mesatarisht, kompanitë e sektorit kanë raportuar të kenë shfrytëzuar 62.9% të kapacitetit të tyre të prodhimit më 2012. Kjo shënon një rritje të përgjithshme në sektor prej 2.4% krahasuar me shfrytëzimin e raportuar të kapacitetit vitin paraprak (2011), kur ishte 60.6%. Megjithatë, sikurse ilustron Figura 6, rritja në shfrytëzimin e kapacitetit ishte shumë më e lartë për kompanitë e mëdha (27%) dhe të mesme (5%), sesa për kompanitë mikro (3%) apo kompanitë e vogla, që kanë përjetuar një rënie të vogël (2%). Ndonëse qarkullimi ka përjetuar një rënie të madhe tek kompanitë më të mëdha më 2012 (që do të shtjellohet në kapitullin e radhës), shfrytëzimi i rritur i kapacitetit po këtë vit mund të jetë i lidhur me rritjen e pritjes së shitjeve më 2013, që është konfirmuar nga të dhënat preliminare të eksportit për 2013 (të gjitha kompanitë e mëdha janë kryesisht të orientuara drejt eksporteve).

Figura 6: Shfrytëzimi i kapacitetit të prodhimit (në %), përgjatë viteve dhe sipas madhësisë së kompanisë



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

4. Tregjet

Të dhënat e ofruara nga anketa e bëjnë të vështirë identifikimin e shifrave të sakta për vlerën totale të shitjeve që i kanë realizuar kompanitë e përpunimit të metalit, apo të tërë sektorit në përgjithësi. Janë dy arsye kryesore për këtë. e para është se ka nëndeklarim të dukshëm të qarkullimit nga këto kompani të cilat nuk janë përgjigjur në pyetjen për shitjet (gjithsej 61% kompani të anketuara mikro dhe të vogla janë pajtuar që të përgjigjen në këtë pyetje). Qarkullimi mesatar që kanë raportuar kompanitë mikro dhe të vogla më 2012 është sa rreth gjysma e madhësisë së kontributeve që kanë raportuar se i kanë shfrytëzuar në procesin e tyre të prodhimit. Një tjetër vështirësi në vlerësimin e numrit total të qarkullimit për sektorin në tërësi është fakti që shumica e kompanive të mesme dhe të mëdha nuk i kanë ofruar fare shifrat e tyre të qarkullimit. Megjithatë, një kombinim i të dhënave të anketës dhe burimeve të tjera sekondare të paktën krijon një mundësi që t'i vërejmë disa trende të përvitshme, apo t'i identifikojmë disa shifra indikative totale të cilat duhet të merren një dozë rezerve.

Sikurse edhe ilustron Tabela 5, kompanitë mikro dhe të vogla kanë raportuar një rritje në shitje ndërmjet vitit 2011 dhe 2012. Më saktësisht, 13 nga 87 kompanitë mikro dhe të vogla (15%) që i janë përgjigjur pyetjes për qarkullimin kanë raportuar rritje në shitje nga viti në vit, ndërsa një nga kompanitë e anketuara ka raportuar ulje të shitjeve. Rritja vjetore për shitjet e këtij segmenti të sektorit është shënuar të jetë 4.8%. Saktësia e kësaj rritjeje të raportuar në shitje mbështetet me faktin që (sikurse që edhe konfirmon anketa) kompanitë mikro dhe të vogla shesin pothuajse të gjitha mallrat e tyre në tregun vendor (shih Tabelën 6) ku, sikurse që edhe konfirmojnë të dhënat nga importi, niveli i kërkesës për produktet e metalit vazhdon të jetë i fortë dhe ka përjetuar rritje më 2012.

Tabela 5: Qarkullimi i kompanive të sektorit më 2011 dhe 2012, mesataret dhe totalët

Madhësia e kompanisë	Qarkullimi mesatar i raportuar më 2011 (€) *	Qarkullimi mesatar i raportuar më 2012 *	% ndryshim	Gjithsej qarkullimi i vlerësuar më 2011	Gjithsej qarkullimi i vlerësuar më 2012
Mikro dhe të vogla	116,293	121,839	+ 4.8%	19,940,996	20,894,886
Mikro	50,758	53,220	+ 4.8 %	8,984,091	9,419,886
Të vogla	322,262	337,500	+ 4.7%	10,956,905	11,475,000
Të mesme dhe të mëdha	N/A	N/A	- 36.8 %	≈ 145,000,000 **	≈ 93,000,000 **
Gjithsej sektori	N/A	N/A	≈ - 31%	≈ 165,000,000 **	≈ 114,000,000 **

* Burimi: Shkalla mesatare është nxjerrë nga anketa.

** Burimi: Për shkak të shkallës së ulët të përgjigjeve, totali për pesë kompanitë e mesme dhe të mëdha është vlerësuar duke përdorur burime të kombinuara: anketa, për kompanitë që janë përgjigjur; b) të dhënat nga Doganat e Kosovës, për kompanitë që janë eksportuese të mallrave të posaçme dhe (sipas përgjigjeve të anketës) eksportojnë 100% të prodhimit të tyre; c) burimet tjera sekondare.

Në anën tjetër, një tjetër fakt i dukshëm është se niveli i përgjithshëm i qarkullimit për sektorin varet tej mase nga shitjet e pesë kompanive të mesme dhe të mëdha – në veçanti të Ferronikelit – që edhe shet shumicën e mallrave të tyre në tregjet e huaja (shih Tabelën 6). Një rënie e ndjeshme në eksportin e nikelit ndërmjet vitit 2011 dhe 2012 (nga €136,4 milionë në €83,6 milionë) çoi në ulje prej rreth 31% në qarkullim për sektorin në tërësi, përkundër trendit pozitiv të kompanive mikro dhe të vogla të sektorit. Të dhënat preliminare tregtare për vitin 2013 tregojnë se eksportet e ferronikelit kanë kthyer trendin pozitivisht, duke arritur pothuajse vlerën totale të eksporteve të ferronikelit më 2012 vetëm në tre tremujorët e parë të vitit 2013.

Nxjerrja e shitjeve mesatare që kanë raportuar kompanitë mikro dhe të vogla në anketë për gjithsej popullatën e vlerësuar të këtyre kompanive, dhe duke përdorur një kombinim të të dhënave të anketës dhe burimeve sekondare për t'i gjetur vlerësimet e përafërta të shitjeve nga pesë kompanitë e mesme dhe të mëdha, gjithsej qarkullimi për sektorin vlerësohet të jetë qenë rreth $\approx$ €165 milionë më 2011 dhe $\approx$ €114 milionë më 2012. Megjithatë, duhet të theksohet se këto shifra do të duhej të ishin më të larta për shkak të shitjeve të padeklaruara nga kompanitë mikro dhe të vogla. Duke e marrë parasysh këtë fakt, viteve të mirat të shitjeve të ferronikelit (€120- €140 milionë në vit), qarkullimi i përgjithshëm për sektorin realisht mund të jetë më afër shifrës €200 milionë.

Siç është ilustruar në Tabelën 6, anketa sugjeron që kompanitë mikro dhe të vogla në Kosovë i shesin shumicën e mallrave të tyre në tregun vendor dhe eksportojnë vetëm një sasi të vogël. Kompania mikro mesatare shet 98.4% të mallrave të saj në tregun vendor dhe vetëm 2.6% jashtë vendit. Tabela 6 tregon se si vazhdon të ulet proporcioni ndërmjet shitjeve vendore dhe të huaja më madhësinë e kompanisë – sa më e madhe të jetë kompania, aq më e madhe do të jetë pjesa e mallrave të eksportuara.

Tabela 6: Përpjesa mesatare e shitjeve vendore dhe jashtë vendit, sipas madhësisë së kompanisë

Madhësia e kompanisë	Shitjet vendore si % e shitjeve totale (mesatarja për kompani)	Shitjet e jashtme si % e shitjeve totale (mesatarja për kompani)
Mikro	98.4 %	2.6 %
Të vogla	74.1 %	25.9%
Mesme	35 %	65 %
Të mëdha	5 %	95 %

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Për shkak të faktit që jo të gjitha kompanitë kanë nivel të njëjtë të qarkullimit dhe se shitjet mesatare për kompani mund të mos jenë të sakta për shkak të këtij dallimi në qarkullim, Tabela 7 paraqet përpjesën e vlerës së qarkullimit të krijuar nga shitjet vendore dhe jashtë vendit më 2012. Kompanitë mikro kanë krijuar qarkullim vendor prej 94.3%, ndërsa kompanitë e vogla, përkundër faktit që shesin, mesatarisht, 74% në vend, shitjet vendore përbënin 89.4% të gjithsej vlerës së mallrave të tyre të shitura. Kompanitë e mesme kanë pasur më shumë se gjysmën e qarkullimit të tyre nga eksportet (56.5%), ndërsa kompanitë e mëdha gati të gjitha i kanë pasur nga jashtë (99.6%).

Tabela 7: Përpjesa e vlerës së shitjeve vendore dhe të huaja më 2012, sipas madhësisë së kompanisë

Madhësia e kompanisë	Vlera e shitjeve vendore si % shitjeve totale	Vlera e shitjeve të jashtme si % shitjeve totale
Mikro	94.3 %	5.4 %
Të vogla	89.4 %	10.6%
Mesme	43.5%	56.5 %
Të mëdha	0.4 %	99.6 %

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Llojet e mallrave që kompanitë mikro dhe të vogla i shesin në tregun e tyre vendor korrespondojnë me veprimtaritë e para të përpunimit të këtyre kompanive (shih Figurat 2 dhe 5) – kryesisht konstruksione dhe struktura metalike që përdoren nga industria e ndërtimtarisë apo pjesë që përdoren nga prodhues të tjerë. Tabela 8 ilustron llojet e blerësve të cilëve kompanitë mikro dhe të vogla u shesin produkte në tregun vendor, si dhe përpjesën përkatëse të vlerës së prodhimit të shitura për to.

Ka dallime të konsiderueshme ndërmjet kompanive mikro dhe atyre të vogla në kuptim të blerësve të mallrave të tyre, duke pasqyruar shkallën, llojet dhe nivelin e ndryshëm të sofistikimit ndërmjet kompanive. Kompanitë mikro, të cilat zakonisht janë të rregulluara si biznese familjare me kapacitet të kufizuar të prodhimit dhe/apo përpunim të sofistikuar, dhe kryesisht veprojnë si punëtori për riparime apo ofrues të shërbimeve, pjesën më të madhe të vlerës së tyre të prodhimit e shesin drejtpërsëdrejti tek përdoruesit fundorë (36.4%) dhe dyqane të vogla (34.3%), dhe një pjesë shumë e vogël (3.4%) tek bizneset tjera për përpunim të mëtejshëm. Kompanitë e vogla, në anën tjetër, gjithashtu shesin një pjesë tek dyqanet e vogla (36.4%). Por ndryshe nga kompanitë mikro, si dhe për shkak të shkallës së tyre më të lartë të prodhimit dhe mekanizmit, një pjesë të rëndësishme të zinxhirit të vlerës së kompanive të vogla gjithashtu e kanë shpërndarësit/shitësit me shumicë (34.3%). Shitjet tek përpunuesit janë gjithashtu më të larta për kompanitë e vogla (7%).


Tabela 8: Shitjet vendore të kompanive mikro dhe të vogla më 2012, sipas llojit të blerësit

Lloji i blerësit	% e gjithsej vlerës së prodhimit të shitur tek blerësi	
	Mikro	Të vogla
Kompani të tjera/përpunim i mëtejshëm	3.4%	7.0%
Distributor / shitës me shumicë	9.9%	34.3%
Dyqan i vogël	34.3%	36.4%
Përdorues fundorë	36.4%	22.1%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Sipas anketës, 17.4% e kompanive të përpunimit të metalit janë eksportues. Numri i kompanive eksportuese, si dhe përpjesa e eksportit të prodhimit të tyre rritet sipas madhësisë së kompanisë (shih Figurën 7 më poshtë).

Figura 7: Kompanitë që eksportojnë dhe eksportet e tyre mesatare më 2012, sipas madhësisë së kompanisë




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Vlera mesatare vjetore e metalit bazë dhe produkteve të metalit (përfshirë skrapin) të eksportuara nga Kosova në periudhën 2010-2012 ishte €132 milionë. Në anën tjetër, më 2012, deficitit tregtar në sektor ishte €332 milionë. Rritja e vazhdueshme në kërkesën vendore për t'i furnizuar projektet e ndërtimit dhe rënia e shpejtë në eksportet e ferronikelit për shkak të krizës ekonomike ka zgjeruar deficitin tregtar gjatë viteve të fundit (shih Figurën 8). Në periudhën ndërmjet 2011 dhe 2012, eksportet janë ulur nga €145.4 milionë në €101 milionë, ndërsa importet janë rritur nga €392 milionë në €433 milionë.

Pavarësisht faktorëve të tillë ciklikë, sektori i metalit vazhdon të jetë sektori më i madh i eksportit në Kosovë. Eksporti i metaleve bazë dhe produkteve të metalit përbënte 36.5% të vlerës së të gjitha mallrave të eksportuara nga Kosova më 2012. Rritja e theksuar në eksportet e ferronikelit më 2013 me gjasë do t'i kthejë eksportet e metalit më afër përpjesës prej 50% të gjithë eksporteve, siç edhe ishte më 2010.


Figure 8: Eksportet e metalit, importet e metalit dhe gjithsej eksporti i mallrave nga Kosova (2010-2012) në milionë €



Burimi: Doganat e Kosovës, 2013

Struktura e eksporteve të sektorit dominohet në masë të madhe nga eksportet e ferronikelit të përpunuar të prodhuar në impiantin Ferronikeli në Gllogoc (shih Figurën 9). Eksportet e ferronikelit përbëjnë 90.8% të gjithsej vlerës së eksporteve të metalit në periudhën 2010-2012. Përpjesa më e madhe e mbetur e eksporteve (6.6%) përbëhet nga produktet e hekurit dhe çelikut – kryesisht gypa, tubacione dhe profile boshe.

Figura 9: Eksportet e metalit, eksportet e ferro-nikelit dhe eksportet e produkteve të hekurit dhe çelikut (2010-2013), në milionë €



Burimi: Doganat e Kosovës, 2013

Tregjet kryesore për eksport të metaleve bazë dhe produkteve të metalit të Kosovës sipas vlerës së prodhimit janë Italia, India, Gjermania, Maqedonia, Shqipëria, Portugalia dhe Zvicra. Gjigantët industrialë dhe eksportuesit kryesorë sipas vlerës së qarkullimit janë të përqendruar në një numër të vogël tregjesh të eksportit. Ferro-nikeli i prodhuar në Ferronikeli eksportohet në Itali, Indi dhe Gjermani, ndërsa Llamkos-Galvasteel eksporton produktet e çelikut të galvanizuar në Portugali dhe Maqedoni. Trepça eksporton tërë zinkun dhe plumbin e saj në Zvicër. Dy kompanitë e mesme, Fabrika e Tubave IMK dhe Jugoterm, eksportojnë mallrat e tyre vetëm në tregje rajonale: Shqipëri, Greqi, Maqedoni, Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë.

Të dhënat nga anketa kanë ofruar mundësinë e vënies në hartë të mallrave të eksportuara sipas llojit të blerësve (shih Tabelën 9). Nuk është befasuese që pothuajse e tërë vlera e eksportuar nga kompanitë e mëdha (97.2%) shitet drejtpërsëdrejti tek kompanitë tjera për përpunim të mëtejshëm. Kjo është për shkak se dy nga kompanitë e mëdha (Ferronikeli dhe Trepça) kanë eksportuar ferro-nikel të përpunuar dhe minerale të zinkut dhe plumbit, të cilat janë lëndë e parë dhe materiale të ndërmjetme për mallra të tjera (për shembull: 2/3 të furnizimit global të nikelit përdoren për prodhimin e çelikut të pandryshkshëm). Kompanitë e vogla dhe të mesme, në anën tjetër, eksportojnë shumicën e mallrave të tyre përmes distributorëve (93.8% dhe 100% përkatësisht). Numri i vogël i kompanive mikro që eksportojnë, e bëjnë këtë drejtpërdrejt në dyqane të vogla (58.9%) apo distributorë (40.7%).


Tabela 9: Pjesa e vlerës totale të mallrave të eksportuara më 2012, sipas llojit të blerësit

Lloji i blerësit	% e vlerës së eksportit				
	Mikro	Të vogla	Të mesme	Të mëdha	GJITHSEJ SEKTORI
Kompani të tjera/përpunim i mëtejshëm	0%	3.8%	0%	97.2%	93.4%
Distributor / shitës me shumicë	40.7%	93.8%	100%	0.3%	4.2%
Dyqan i vogël	58.9%	1.2%	0%	0.3%	0.4%
Përdorues fundorë	0.4%	1.2%	0%	2.2%	2%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Kompanitë mikro dhe të vogla aktualisht eksportojnë një pjesë më të vogël të mallrave të tyre, por shumë prej tyre theksojnë se synojnë një gjë të tillë në të ardhmen. Siç ilustron Figura 10, synimi për eksport, siç edhe pritej, shkon sipas madhësisë së kompanisë. Një pjesë më e madhe e kompanive të vogla (78.9%) theksojnë se synojnë të eksportojnë dikur në të ardhmen, krahasuar me kompanitë mikro (54.7%). Kufizimet me të cilat përballen bizneset në kuptim të eksportit kanë më shumë të bëjnë me çështje brenda biznesit sesa çështje të jashtme. Siç është ilustruar në diagram, një pjesë më e madhe e kompanive mikro dhe atyre të vogla mendojnë se kompanitë e tyre nuk janë ende të gatshme për eksporte (32.1% dhe 47.4% përkatësisht), ndërsa një pjesë më e vogël mendojnë se ka pengesa të shumta për një gjë të tillë (22.6% dhe 31.5%).

Figure 10: Përpjesa e kompanive mikro dhe të vogla me synim drejt eksportit më 2012



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Rubrika 2: Rregulloret tregtare

Si anëtare e Marrëveshjes CEFTA, Kosova ka regjim të tregtisë së lirë me një treg prej 24 milionë banorëve. Marrëveshja për tregti të lirë me Turqinë ka hyrë në fuqi më 1 janar 2014 dhe negociatat janë në vijim për MSA me BE-në. Kompanitë e Kosovës gjithashtu kanë qasje pa detyrime doganore në tregun e SHBA-së.

5. Punësimi dhe kapacitetet njerëzore


Veprimtaria e përpunimit të metalit përgjithësisht kërkon shumë kapital, por gjithashtu kërkon një numër të konsiderueshëm punonjësish, duke përfshirë ata me shkathtësi specifike për të operuar një gamë të gjerë të makinerive dhe mjeteve. Vlerësimet për numrin e përafërm të punëtorëve për 216 kompanitë në sektorin e përpunimit të metalit janë 4496. Siç është ilustruar në Figurën 11, punësimi në sektorin e përpunimit të metalit përbën 1.5% të gjithsej punësimit në Kosovë që, sipas Anketës së fundit të tregut të punës, është 302,844 persona.

Tabela 10: Numri i kompanive dhe punëtorëve në sektor më 2012, (mesataret dhe totalët sipas madhësisë së kompanive)

Madhësia e kompanive	Numri mesatar i punëtorëve	Numri i përafërt i përgjithshëm i punëtorëve
Mikro	4	622
Të vogla	18	622
Të mesme	240	480
Të mëdha	923	2,771
GJITHSEJ	/	4,496

Burimi: Anketa e UNDP, 2013


Figura 11: Punësimi total dhe punësimi në sektorin e metalit më 2012



Burimi: Anketa e UNDP, 2013
Anketa e Tregut të Punës në Kosovë, 2012

Shumica dërmuese e punonjësve janë të punësuar nga pesë kompanitë më të mëdha të industrisë. Siç është ilustruar në Figurën 12, 61.6% të atyre të punësuar në sektor punojnë për tri kompanitë e mëdha, ndërsa një pjesë shumë më e vogël e tyre punojnë për kompanitë tjera të mesme (10.7%), të vogla (13.8%) apo mikro (13.8%). Kompanitë mikro mesatarisht punësojnë ndërmjet 3-4 punëtorë, ndërsa kompanitë e vogla rreth 18.

Figura 12: Përpjesa e punësimit të sektorit sipas madhësisë së kompanive, 2012



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Kompanitë e anketuara janë kërkuar që të theksojnë shumën e resurseve financiare që shpenzojnë për muaj në paga. Kur janë ndarë sipas numrit të punëtorëve që kanë raportuar se janë të punësuar, paga mesatare për kompanitë mikro dhe të vogla më 2012 është vlerësuar të jetë €296 në muaj (shih Tabelën 11). Ndonëse shkalla e përgjigjeve të kompanive në pyetjet që kanë të bëjnë me pagat dhe numrin e punonjësve ishte shumë e lartë, saktësia e këtij numri duhet të shihet me një dozë dyshimi, duke pasur parasysh gjasat e nëndeklarimit të kompanive qoftë të numrit të punëtorëve të tyre qoftë të shpenzimeve të tyre për paga. Megjithatë, një konkluzë që mund të nxirret me një shkallë më të lartë të besueshmërisë është se pagat janë shumë më të larta për punonjësit në kompanitë e vogla sesa ato mikro – që është pasqyrim logjik i shkallës më të gjërë operacionale, sofistikimit operacional, qarkullimit dhe shkathtësive të punëtorëve.

Tabela 11: Paga mesatare mujore më 2012, sipas madhësisë së kompanive


Madhësia e kompanive	Paga mesatare mujore (€)
Mikro	282
Të vogla	338
Gjithsej (Mikro dhe të vogla)	296

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Ndoshta nuk është befasuese që për shkak të natyrës fizike të detyrave të përpunimit në industri, fuqia punëtore e sektorit dominohet bindshëm nga burrat. Siç është ilustruar në Figurën 13, 95% të fuqisë punëtore të sektorit janë burra dhe vetëm

5% janë gra. Pabarazia gjinore në fuqinë punëtore të sektorit është dukshëm më e lartë sesa ajo në punësimin e përgjithshëm të popullatës së Kosovës, ku 79% të personave të punësuar janë burra dhe 21% janë gra.


Figura 13: Punësimi sipas gjinisë në NVM-të në sektorin e metalit dhe të gjithë sektorët më 2012



Burimet: NVM-të e sektorit të metalit (anketë)
Të gjithë sektorët: (Anketa e fuqisë punëtore në Kosovë 2012)

Personat e punësuar në industrinë e përpunimit të metalit në Kosovë gjithashtu dallojnë nga popullata e përgjithshme e punësuar në kuptim të nivelit të kualifikimit arsimor. Krahasuar me popullatën e përgjithshme të punësuar, fuqia punëtore në sektorin e metalit ka shkallë shumë të lartë të personave që kanë kryer shkollën e mesme (shih Figurën 14) dhe numër shumë më të ilet të atyre që kanë kryer shkollimin e lartë apo fillor. Përsëri, kjo nuk është befasuese meqë për shumicën e punëtorëve të metalit zakonisht nuk kërkohet njohuri e lartë e sofistikuar apo njohuri e hollësishme teorike që mësohen në shkollim të lartë (ndoshta me përjashtim të inxhinierëve të plumbit), por vetëm shkathtësi mesatare teknike, praktike dhe logjike për të cilat shkolla e mesme shpeshherë është e mjaftueshme (dhe shkollimi profesional është optimal).

Figura 14: Niveli i kualifikimit arsimor tek punëtorët e sektorit të metalit dhe popullatës së përgjithshme të punësuar të Kosovës më 2012




Burimet: NVM-të e sektorit të metalit: Anketa e UNDP, 2013
Gjithsej popullata e punësuar: Anketa e fuqisë punëtore në Kosovë

Për shkak të faktit që përpunimi i metalit ka një histori të konsiderueshme në Kosovë, numri dhe shtrirja e shkathtësive relevante për sektorin janë të konsiderueshme. Megjithatë, anketa ka konstatuar se 29.5% të kompanive të sektorit theksojnë se industria ka mungesë të punonjësve të kualifikuar. Gjersa kompanitë e mesme dhe të mëdha me përvojë raportojnë pak apo fare vështirësi me shkathtësitë e fuqisë punëtore, këto të fundit janë veçanërisht problematike për kompanitë e vogla (shih Figurën 15). Kjo mund të shihet si indikacion i sfidës me të cilën përballen kompanitë ambicioze në ngritjen e tyre dhe rritjen e konkurrueshmërisë duke tejkaluar modelin e biznesit tradicional familjar.

Në mesin e atyre kompanive që kanë theksuar se punonjësit e kualifikuar janë çështje shqetësuese, 73.2% mendojnë se shkollat profesionale nuk prodhojnë numër të mjaftueshëm të të diplomuarve, ndërsa 64.9% mendojnë që punëtorët e sektorit janë të shtrenjtë. Në anën tjetër, gjithsej 20.1% të të gjitha kompanive të sektorit (duke përfshirë tri nga pesë kompanitë e mesme dhe të mëdha) kanë raportuar se ofrojnë të paktën një nivel të aftësimi për punëtorët e tyre. Lloji më i shpeshtë i trajnimeve të ofruara janë trajnimet në vend të punës.

Figura 15: Përpjesa e kompanive mikro dhe të vogla që janë përgjigjur pozitivisht ("po" dhe "disi") në pyetjen: "A ka industria juaj mungesë të punëtorëve të aftë/kualifikuar?"



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Anketa ka kërkuar nga kompanitë e sektorit që t'i cekin llojet e punëtorëve që mendojnë se mungojnë në tregun e punës, bazuar në Kategorizimin Ndërkombëtar Standard të Profesioneve. Sipas përgjigjeve të respondentëve, llojet e punonjësve që janë përmendur më së shpeshti se mungojnë janë operatorët e fabrikës (impiantit) – gjegjësisht operatorët të furrave, shkrirjes, operatorë të trajtimit me ngrohje dhe tërheqës. Llojet tjera më të cekura të punëtorëve janë punonjës të fletëve të metalit dhe operatorë të mjeteve makinerike. Lista e plotë e shkathtësive që mungojnë është paraqitur në Tabelën 12.

Tabela 12: Profesionistët që janë cekur më së shpeshti se mungojnë në tregun e punës (sipas shpeshësisë që janë përmendur, në pajtim me Kategorizimin ndërkombëtar standard të profesioneve)

Operator i impiantit të përpunimit të metalit
Punëtorë të fletëve të metalit
Operatorë të mjeteve të makinerisë
Bluarës me rrotë metalike
Lustrues dhe mprehës të mjeteve
Operatorë kabllorësh
Përgatitës të strukturave metalike
Saldues

Burimi: Anketa e UNDP, 2013


Rubrika 3: Legjislacioni i tregut të punës në Kosovë: përmbledhje

Tejet fleksibil. Shkallë progresive të të ardhurave: 0-10%. Kontributet e punëdhënësit 5% të gjithsej pagës së punonjësit për pension. Paga minimale është €170 për personat mbi moshën 35 vjeçe dhe €130 për personat nën moshën 35 vjeçe. Legjislacioni kryesor: Ligji për punën (nr. 03/L-212) dhe Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë (nr. 04/L-161)

6. Asetet dhe investimet

Të dhënat e anketës ofrojnë mundësi të mirë për vlerësim të aseteve (tokave, ndërtesave dhe teknologjisë) në posedim të kompanive mikro dhe të vogla në industri si dhe identifikimin e trendeve relevante të investimit më 2012. Të dhënat për asetet dhe investimet për pesë kompanitë e mesme dhe të mëdha nuk janë në dispozicion. Siç është ilustruar në Figurën 16, shumica e kompanive mikro dhe të vogla kanë theksuar se kanë në pronës tokën dhe objektin, dhe pothuajse të gjitha kompanitë (100% të kompanive të vogla) kanë theksuar se posedojnë mjete teknologjike në asetet e tyre. Nuk është për t'u befasuar se edhe përpjesa e pronësisë edhe vlera mesatare e aseteve në pronësi janë më të larta për kompanitë e vogla sesa për ato mikro. Për shembull, 79.2% të kompanive të vogla kanë raportuar se kanë në pronësi tokë, krahasuar me 59.1% të kompanive mikro. Vlera mesatare e tokës në pronësi të kompanive të vogla është €436,542, ndërsa për kompanitë mikro është €137,888 (shih Tabelën 12).

Figura 16: Përpjesa e kompanive mikro dhe të vogla që kanë në pronësi asete më 2012



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Bazuar në raportimin vetjak të kompanive në anketë, vlera e përgjithshme e të gjitha aseteve (tokë, ndërtesa dhe teknologji) në pronësi të kompanive mikro dhe të vogla më 2012 është vlerësuar të jetë €70,6 milionë (shih Tabelën 12). Përpjesa më e madhe në vlerën totale të aseteve të vlerësuara i takon tokës (€ 26,2 milionë), vijuar nga teknologjia (€ 24,3 milionë) dhe ndërtesat (€20,1 milionë). Këto numra janë nxjerr nga shumëzimi i vlerës mesatare të aseteve në pronësi për kompani me kompanitë e përgjithshme të vlerësuara që kanë në pronësi asete të tilla.

Tabela 13: Vlera e përafërt totale e aseteve në pronësi më 2012 nga të gjitha kompanitë e mikro dhe të vogla

Madhësia e kompanisë	Vlera totale e vlerësuar e tokës në pronësi (€)	Vlera totale e vlerësuar e ndërtesave në pronësi (€)	Vlera totale e vlerësuar e teknologjisë në pronësi (€)	Vlera totale e vlerësuar e aseteve në pronësi (€)
Mikro	14,399,644	8,635,803	8,575,576	31,611,023
Të vogla	11,786,634	11,471,325	15,717,928	38,975,887
Mikro + Të vogla	26,186,278	20,107,128	24,293,504	70,586,910

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Vlerat totale të tërë sektorit të aseteve në pronësi mund të mos japin më shumë njohuri mbi nivelin e përparimit teknologjik të kompanive. Meqë përbërësi kryesor në operacionet e përpunimit të metalit është posedimi i teknologjisë (p.sh. makineri, vegla, etj.), një mënyrë më e mirë për ta kuptuar nivelin e sofistikimit të kompanive mund të jetë vlerësimi i shkallës mes vlerës mesatare të aseteve të paluajtshme në pronësi (tokë dhe ndërtesa) dhe vlerës mesatare të teknologjisë në pronësi për firmë (shih Tabelën 13). Për kompanitë mikro që kanë deklaruar se kanë në pronësi patundshmëri (tokë dhe ndërtesa), vlera e tyre është shumë më e lartë sesa vlera e teknologjisë në posedim me një raport prej 4.5 me 1. Për kompanitë e vogla, në anën tjetër, aset më i çmuar është teknologjia. Vlera mesatare e teknologjisë në pronësi për kompanitë e vogla vlerësohet të jetë €462,292 ndërsa raporti i patundshmërisë me teknologjinë është 2:1. Këto raporte ilustrojnë nivelin e lartë të mekanizimit dhe sofistikimit teknologjik të kompanive të vogla.

Tabela 14: Asetet e kompanive mikro dhe të vogla më 2012 (mesatarja dhe raporti)

Madhësia e kompanisë	Vlera mesatare e tokës në pronësi (€)	Vlera mesatare e tokave në pronësi (€)	Vlera mesatare e teknologjisë në pronësi (€)	Raporti i patundshmërisë (toka + ndërtesat) me teknologjinë
Mikro	137,888	87,137	49,858	4.5 : 1
Të vogla	436,542	458,853	462,292	2 : 1

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Ka trende pozitive në sektor për sa i përket investimeve në asete, posaçërisht investimeve në teknologji. Të dhënat e anketës tregojnë se ndërmjet viteve 2011 dhe 2012, vlera totale e të gjitha aseteve në kompanitë mikro dhe të vogla është rritur për 3.9% (shih Tabelën 15). Më së rëndësishmi, rritja më e madhe, 10.3%, është parë në vlerën e teknologjisë në posedim. Gjithashtu, është interesant të theksohet se pronësia e ndërtesave ka rënë për 4.3%. Një vështrim më i afërt i të dhënave tregon se kjo

rënie është shkaktuar në masë të madhe nga shitja e ndërtesave të vlefshme tek disa kompani të vogla, disa prej të cilave në të njëjtën kohë kanë raportuar se kanë rritur investimet e tyre në teknologji.


Tabela 15: Ndryshimi ndër vite në vlerën totale të aseteve në pronësi të kompanive mikro dhe të vogla, sipas llojit të asetit

Lloji i asetit	Ndryshimi vit pas viti në % në vlerën e pronës (2011 deri 2012)
Tokë	5.3 %
Ndërtesa	- 4.3 %
Teknologji	10.3 %
Të gjitha asetet	3.9%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Gjithsej, 19.7% të kompanive të sektorit kanë raportuar se kanë bërë investime kapitale më 2012. Rritja në vlerën totale të aseteve është kryesisht si pasojë e investimeve të kompanive të vogla. Siç është ilustruar në Figurën 17, 28.6% të kompanive të vogla kanë raportuar se kanë bërë investime më 2012 të cilat kishin vlerë mesatare prej €72,500. Në anën tjetër, 17.1% të kompanive mikro kanë investuar një vlerë mesatare prej €9,016. Një kompani e mesme ka raportuar t'i ketë investuar €150,000. Pothuajse të gjitha kompanitë që kanë investuar kanë thënë se kanë avancuar teknologjinë e tyre përmes blerjes së makinerisë së re dhe linjave të montimit.

Figura 17: Përpjesa e kompanive që kanë investuar më 2012. Vlera mesatare e investimit.



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Të dhënat e anketës konfirmojnë se operacionet e mihjes dhe përpunimit të metalit përgjithësisht kërkojnë shumë kapital për shkak të kostove të larta të blerjes dhe mirëmbajtjes së makinerisë dhe, varësisht nga shkalla, hapësira fizike e nevojshme për veprimtari. Për shembull, kompanitë e vogla që kanë në pronësi asete në Kosovë kanë raportuar se më 2012 ato kanë pasur mesatarisht në pronësi tokë

në vlerë prej €437,000, ndërtesa në vlerë prej €459,000, dhe teknologji në vlerë prej €462,000. Në anën tjetër, shpenzimet vjetore të punës dhe qarkullimi janë vlerësuar të jenë €74,000 dhe €338,000 përkatësisht. Shifra e qarkullimit duhet të shihet vetëm si indikative për shkak të nëndeklarimit të mundshëm. Megjithatë, edhe me një shkallë të lartë të nëndeklarimit (të themi prej 30%), është e qartë se intensiteti i kapitalit i veprimtarisë edhe më tej do të jetë shumë i lartë.

Tabela 16: Vlera mesatare e aseteve të kompanisë, kostot e punës dhe qarkullimi më 2012

Madhësia e kompanive	Toka në pronësi (mesatarja e atyre që kanë pronë) (€)	Ndërtesat në pronësi (mesatarja e atyre që kanë pronë) (€)	Teknologjia në pronësi (mesatarja e atyre që kanë pronë) (€)	Kostot vjetore të fuqisë punëtore (mesatare)	Qarkullimi vjetore (mesatar)
Mikro	137,888	87,137	49,858	16,764	53,220
Të vogla	436,542	458,853	462,292	73,750	337,803

Burimi: Anketa e UNDP, 2013


Një komponent i rëndësishëm në avancimin teknologjik të kompanive të sektorit janë inovacionet në procesin e prodhimit, marketing dhe menaxhim, si dhe investimet e mundshme në hulumtim dhe zhvillim. Kompanitë e anketuara nuk kanë raportuar të kenë bërë ndryshime të konsiderueshme për sa i përket strukturave organizative dhe përpjekjeve të marketingut, ndërsa vetëm një numër i vogël i tyre kanë raportuar se kanë bërë ndryshime në proceset e tyre të prodhimit.

7. Mjedisi i biznesit

Anketa ka vlerësuar shkallën e kënaqësisë dhe pakënaqësisë të kompanive të përpunimit të metalit me mjedisin e biznesit në Kosovë. Kompanitë e anketuara janë pyetur që të vlerësojnë, në një shkallë nga 0 deri 17 – ku 0 përfaqëson vlerën minimale dhe 17 vlerën maksimale – nëse një çështje ose institucion i veçantë ishte pengesë ose barrierë për veprimtarinë e tyre të punës. Rezultatet mesatare për secilën nga çështjet janë paraqitur në formë grafike në Figurën 18.

Kompanitë e përpunimit të metalit në Kosovë duket të jetë në përgjithësi të kënaqura me procedurat e regjistrimit të biznesit, infrastrukturën lokale dhe qasjen në tokë. Rezultati mesatar për këto çështje është rreth 6 pikë të shkallës – mjaft më ulët se vlera mesatare prej 8.5. Kjo ndoshta nuk është për t'u habitur duke marrë parasysh zbatimin e suksesshëm të reformave në procedurat e regjistrimit të biznesit gjatë dy viteve të fundit, si dhe sasinë e madhe të fondeve publike apo të donatorëve që janë shpenzuar në projekte lokale të infrastrukturës publike që nga viti 1999. Çështje të tjera që janë vlerësuar më ulët sesa vlera mesatare e shkallës janë kostot dhe cilësia e fuqisë punëtore (problem më i madh vetëm për kompanitë e vogla), dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor.

Figura 18: Pengesat për biznese (rezultatet mesatare, në shkallë nga 0-17 – 0 minimale, 17 maksimale)




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Siç ilustruhet në diagram, sfida më e madhe që kanë raportuar kompanitë është kërkesa e ulët për prodhimet e tyre në tregun e brendshëm. Fuqia e ulët blerëse në tregun vendor ka një rezultat mesatar prej 11 pikësh të shkallës. Duke pasur parasysh se importet e metaleve janë në rritje të vazhdueshme përgjatë viteve dhe se rritja ekonomike ka qenë pozitive, ky shqetësim i shprehur nga kompanitë mund të jetë shenjë se tregu i brendshëm është ngopur për strukturën e tanishme të prodhimit të brendshëm, me shumë kompani që shesin mallra dhe shërbime të njëjta, dhe se rritja e kompanive mund të mos jetë e mundur pa diversifikimin e produkteve/shërbimeve të përshtatura për tregun e brendshëm dhe/ose zgjerimin drejt tregjeve të huaja. Një pengesë tjetër e përmendur shpesh nga kompanitë e anketuara është konkurrenca nga sektori joformal. Rezultati mesatar për këtë çështje ishte 10.9.

Një çështje shqetësuese, që veçanërisht pengonte investimet në teknologji, është kostoja e financimit. Kjo çështje ka marrë një vlerësim prej 9.9 në anketë. Kostoja e lartë e financimit në Kosovë në të gjithë sektorët është fakt i njohur mirë dhe i konfirmuar nga burimet tjera. Që nga tetori 2013, Banka Qendrore e Kosovës ka raportuar se norma efektive e kamatës për kreditë e reja është 11.72%.² Në anën tjetër, norma efektive e kamatës në kreditë investuese deri në pesë vite ishte më e ulët, 10.21%. Shumica e kompanive të përpunimit të metalit në përgjithësi mendojnë se kostot e financimit janë shumë të larta (24.6%) apo të larta (21.4%), ndërsa kompanitë e vogla janë më të pakënaqurat.

Figura 19: “Si do ta përshkruanit më së miri koston e financimit për sektorin tuaj?” (Kompanitë mikro dhe të vogla)



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Një tjetër çështje që kishte pakënaqësi të lartë të kompanive është norma e tatimeve. Ajo mori rezultat mesatar prej 9.7. Lista e tatimeve të përgjithshme, që po ashtu prekin edhe sektorin e përpunimit të metalit, janë të listuara në rubrikën më poshtë. Gjithashtu është e përfshirë edhe pagesa e tantiemës për mihje, që është taksë specifike për sektorin. Shumica e kompanive mikro dhe të vogla e shohin nivelin e tatimeve ose si shumë të larta (14.5%) ose të larta (38.4%). Një përpjesë shumë e vogël e tyre mendojnë se tatimet janë të ulëta (2.9%) apo shumë të ulëta (3.6%).

2 Banka Qendrore e Kosovës. “Buletini i statistikave mujore (nr. 146)”, tetor 2013.

Rubrika 4: Tatimet e sektorit


Tatimet për mihjen e mineraleve metalike: 5% për kg të argjendit, arit, mineraleve të platinës dhe xehet e platinës, 4.5% për kg të xeheve të tjera metalike.

Tatimi në të ardhura të korporatës: 3-10% në të ardhurat ndërmjet €5,000 – €50,000; 10% në të ardhurat më të larta sesa €50,000;

Tatimi në vlerë të shtuar: 16% në të gjitha mallrat dhe shërbimet

Tatimi në të ardhurat personale (progresive): 0-10 %

Figura 20: “Si do t’i përshkruanit më së miri normat tatimore?” (Kompanitë e vogla dhe mikro)



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Sikurse shumë biznese të sektorëve të tjerë, kompanitë e përpunimit të metalit kanë shkallë të lartë të bashkëveprimit me organet qeveritare, ose si subjekte të funksioneve të tyre rregullative apo të mbledhjes së të hyrave, ose si furnizues të mallrave dhe shërbimeve përmes kontratave të prokurimit publik. Rubrika në vijim paraqet një listë të shkurtër të disa institucioneve, ligjeve dhe rregulloreve, si dhe licencave dhe lejeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me sektorin e përpunimit të metalit, pa ato që janë shumë të përgjithshme dhe relevante për të gjithë sektorët ekonomikë.

Rubrika 5: Lista e institucioneve kryesore relevante për sektorin

Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Ministria e Financave

Shoqata e përpunuesve të metalit

Ministria e Zhvillimit Ekonomik është aktori kryesor qeveritar i përfshirë në hartimin e politikave dhe legjislacionit që kanë të bëjnë me minierat, duke pasur edhe (së bashku me Ministrinë e Financave) një rol kyç në krijimin dhe shqyrtimin e listës së tantimave. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është agjencia kryesore rregullative, që lëshon dhe inspekton licenca për mihje dhe kërkim (shih listën e plotë të licencave në rubrikën më poshtë). Një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave, ofrimin e formave të ndryshme të mbështetjes dhe mbikëqyrjes së tregut luan Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Rubrika 6: Licencat dhe lejet që kanë të bëjnë me sektorin

Siç është theksuar në Ligjin për miniera dhe minerale:

Licenca për hulumtim,

Licenca për mbajtje,

Licenca për mihje,

Licenca për mihje artizanale.


Ligjet kryesore që rregullojnë komponentin e minierave të sektorit janë Ligji për Miniera dhe Minerale Ligji për themelimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Përveç ligjeve të tjera të përgjithshme për të gjithë sektorët e ekonomisë, ligjet tjera më specifike që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin e përpunimit të metaleve janë Ligji për punimet nga metalet e çmuara, produktet e çmueshme metalike dhe produkteve të ndërtimit. Një vendim veçanërisht i rëndësishëm i qeverisë, i miratuar nga Kuvendi në maj të vitit 2012, është Lista e Tantiemave të Mihjes.

Rubrika 7: Ligjet që lidhen drejtpërsëdrejti me sektorin

- *Ligji për miniera dhe minerale (Ligji nr. 03/L – 163)*
- *Ligji 2005/2 për themelimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale*
- *Ligji për ndryshimin e Rregullores së UNMIK nr. 2005/2 për themelimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale*
- *Ligji për produktet e ndërtimeve (Ligji nr. 04-L/181)*
- *Ligji për produktet e metaleve të çmuara (2004/28)*
- *Ligji për punimet nga metalet e çmuara (Ligji nr. 04-L-154)*
- *Lista e tantiemave të mihjes (aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 12 maj 2012)*
- *Ligji për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor (nr. 04/L-163)*

Siç ilustron Figura 18, kompanitë e sektorit duket të jenë mjaft të pakënaqura me nivelin e korrupsionit në institucionet qeverisëse, meqë kjo çështje ka marrë një rezultat mesatar prej 9.4 (dukshëm më lartë se vlera mesatare prej 8.5). Pakënaqësia është gjithashtu paksa mbi vlerën mesatare për çështjet që kanë të bëjnë me efikasitetin e agjencive që mbledhin të hyra, përkatësisht Doganave të Kosovës (rezultat mesatar prej 8.8) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (rezultati mesatar 8.7). Siç ilustron Figura 21, pjesa më e madhe e kompanive kanë vlerësuar efikasitetin e këtyre dy institucioneve si mesatar (53.8% për Administratën Tatimore dhe 45.1% për Doganën e Kosovës). Pakënaqësia me efikasitetin e sistemit gjyqësor në sigurimin e sundimit të ligjit (shih Figurën 18) është paksa më e ulët sesa ajo me institucionet e tjera – duke marrë rezultat mesatar prej 7.7 të shkallës prej 17 pikëve, por megjithatë mbetet i lartë.

Figura 21: “Si do ta vlerësonit efikasitetin e Administratës Tatimore dhe Doganave të Kosovës?”



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Deri tani nuk ka pasur masa stimuluese qeveritare që drejtpërdrejt synojnë sektorin e përpunimit të metaleve. Megjithatë, ekzistojnë disa masa stimuluese qëllimi i të cilave është mbështetja e prodhuesve vendorë në përgjithësi dhe që janë të rëndësishme edhe për kompanitë e përpunimit të metalit. Kohëve të fundit ato janë grumbulluar në një ligj të vetëm – gjegjësisht Ligjin mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor. Stimulimi më i rëndësishëm në këtë drejtim është tarifa doganore 0% për importin e makinerive dhe të lëndës së parë që janë të destinuara për përpunim të mëtejshëm nga kompanitë e prodhimit.

Një tjetër masë stimuluese ekzistuese është lejimi i zbritjes së tatimit të veçantë që ulë për 10% çmimin e blerjes së pajisjeve të rënda (linjat prodhuese për impiante dhe makineri) dhe automjete të rënda të transportit. Prodhuesit gjithashtu kanë mundësi të shtyrjes së pagesës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar për impiantet dhe makineritë e importuara deri në gjashtë muaj, në mënyrë që të lejohet që impiantet të jenë funksionale para se të paguhet tatimi.

Një komponent e rëndësishme e mjedisit biznesor është edhe korniza legjislative lidhur me pronësinë industriale, i cili është e përgjithshme dhe e rëndësishme për të gjithë sektorët e biznesit dhe kështu ndikon edhe në sektorin e përpunimit të metaleve. Lidhur me këtë, të drejtat e pronësisë industriale regjistrohen dhe administrohen nga Agjencia për Pronësi Industriale që vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Markat tregtare: janë të rregulluara me ligjin për markat tregtare (nr. 04/L-026). Pronari i markës së regjistruar tregtare, pas regjistrimit, do të ketë të drejta ekskluzive lidhur me mallrat apo/dhe shërbimet e mbuluara nga regjistrimi. Mbajtësi i markës tregtare ka të drejtë të parandaloj palët e treta të përdorin markën pa lejen e tij. Në veçanti, këto të drejta përfshijnë: shfrytëzimin e markës tregtare, autorizimin e një personi tjetër për shfrytëzimin e markës tregtare ose për të shfrytëzuar mjete juridike për shkelje të markës tregtare. Marka tregtare është e regjistruar për një periudhë prej 10 viteve dhe mund të rinovohet për një kohë të pakufizuar.

Dizajni industrial: rregullohet me Ligjin mbi Dizajnin Industrial (Ligji Nr.04/L-028) dhe dizajni është i mbrojtur me ligj deri në masën që është një risi dhe ka një karakter të veçantë. Mbrojtja e dizajnit industrial zgjatë pesë vite dhe mund të zgjatet maksimalisht për 25 vite.

Patentat: rregullohen me Ligjin mbi Patentat (Ligji Nr. 04/L-029). Një shpikje do të jetë e patentueshme nëse ajo është e re, përfshin një hap inventiv, dhe është e zbatueshme në industri. E drejta e patentës jepet për kohëzgjatje prej 20 viteve.

8. Konkluzë

Industria e përpunimit të metaleve është industri me histori dhe traditë të madhe në Kosovë, veçanërisht në mihjen dhe përpunimin bazik të rezervave kryesore të xeheve metalike në Kosovë, si dhe prodhimin e produkteve fundore, si tubat apo radiatorët. Gjersa gjigantët tradicionalë industrialë kanë kaluar nëpër një proces të rishturimit dhe privatizimit (me përjashtim të Trepçës), shumë kompani të reja janë shfaqur dhe janë rritur në periudhën e pas vitit 1999 në përgjigje të kërkesës gjithnjë e më të madhe nga bumi i sektorit të ndërtimit.

Të dhënat e ofruara nga anketa tregojnë se sektori ka arritur një pikë të ngopjes me strukturën aktuale të prodhimit dhe se ajo mund të zgjerohet vetëm nëse kjo strukturë diversifikohet dhe përmirëson cilësinë. Kjo do të mundësonte zëvendësimin e një pjese të importeve të larta të metalit ose depërtim më të madh në tregjet e eksportit. Ka shenja pozitive se disa kompani të sektorit janë duke investuar në makineri të reja dhe po shfrytëzojnë masat stimuluese fiskale, të cilat do të duhej ta përmirësonin efikasitetin dhe cilësinë e produkteve. Megjithatë, ekzistojnë edhe më tej disa pengesa të konsiderueshme.

Nga perspektiva e politikave, llojet e kompanive që do të kenë nevojë për vëmendje më të madhe janë grupi prej 34 kompanive të vogla të cilat po përpiqen të kalojnë përtej modelit të bizneseve tradicionale familjare, drejt operacioneve në shkallë të madhe dhe të bazuar në efikasitet. Këto kompani veçse kanë përvojë të konsiderueshme në prodhim dhe interesim që të bëhen eksportues. Prandaj, ato jo vetëm që mund të jenë shtytës të rritjes së këtij sektori në të ardhmen, por edhe mund të bëhen krijuese të konsiderueshme të vendeve të punës në një sektor që përndryshe është intensiv për nga kapitali.

Megjithatë, këto kompani përballen me disa vështirësi që pengojnë investimet, në veçanti normat e larta të kamatës dhe sundimi i ligjit. Sigurimi i cilësisë më të lartë të produkteve dhe kalimi drejt prodhimit me vlerë më të lartë të shtuar gjithashtu kërkon shkathtësi bashkëkohore dhe të sofistikuara të fuqisë punëtore, dhe të dhënat nga anketa konfirmojnë se kjo e fundit është posaçërisht problematike për kompanitë e vogla. Rrjetëzimi dhe standardet e cilësisë janë fusha të tjera ku mund të jetë e nevojshme mbështetja për shkak të shkallës së lartë të shitjeve ndërmjet bizneseve dhe standardeve të larta rregullative në tregjet e BE-së (p.sh. për produktet e ndërtimit).



MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË

www.mti-ks.org